



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23 regjistër (JR)
Datë 30.05.2022

Nr. 21 i vendimit
Datë 13.03.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 13.03.2025, ditën e enjte, në orën 9:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 23/2022 (JR), datë 30.05.2022, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, të paraqitura në ankim, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose lënien në fuqi të këtij vendimi, si dhe parashtrimet e bisedimet përfundimtare të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Altin Dumani, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe avokates së saj Romina Zano, të cilat përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë në Komision raportin¹, në të cilin ka konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.08.2018.

2.2. DSIK-ja, pasi ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin², e deklasifikuar plotësisht, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova.*

2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit - vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 524, datë 08.04.2022, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

² Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2021, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, i KLP-së, me nr. {***} prot., datë 18.06.2021.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankimin nr. {***} prot., datë 24.04.2022⁴ kundër vendimit nr. 524, datë 08.04.2022 të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Elfrida Bregova, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, ka çmuar se procesi i hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë e për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Nëpërmjet ankimit, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, Komisioneri Publik ka synuar kontrollin e vendimit nr. 524, datë 08.04.2022 të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në përmbajtjen e akteve të dosjes së rivlerësimit, për subjektin dhe personin e lidhur me të, referuar përcaktimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të faktit se raporti i DSIK-së është hartuar pa u administruar informacioni i Shërbimit Informativ Shtetëror, bazuar në nenin C, pika 2 dhe nenin F, pikat 3 dhe 7, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar ankimin ndaj vendimit nr. 524, datë 08.04.2022 të Komisionit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës.
7. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë në mënyrë alternative:
 - o Ndryshimin e vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Elfrida Bregova.
Ose:
 - o Lënien në fuqi të këtij vendimi.
8. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 8.1. Për pasurinë “apartament me sip. 87,3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m²”, në Tiranë, përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është plotësisht i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me pagesën e kryer nga personi i lidhur pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 21.493,55 euro.
 - 8.2. Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se, në referencë të nevojës së kryerjes së një hetimi të plotë dhe verifikimit të ekzistencës eventuale të të gjitha kushteve të parashikuara nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, mangësitë në hetimin e Komisionit, edhe në drejtim të administrimit të plotë të informacioneve nga të gjitha organet ndihmëse për kriterin e kontrollit të

⁴ Ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

figurës, sikurse parashikon kreu V i këtij ligji, për sa kohë rezulton të mos jetë administruar informacioni i Shërbimit Informativ Shtetëror, do të duhet të riparohen gjatë gjykimit të këtij ankimi në Kolegj.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, në përputhje me arsyetimin në vijim në këtë vendim.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 524, datë 08.04.2022, për subjektin e rivlerësimit Elfrida Bregova, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve⁵.
12. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 27.01.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
13. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 27.01.2025, subjekti i rivlerësimit, në vijim të parashkrimeve, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e akteve të paraqitura prej saj, që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes⁶.

⁵ Seancat gjyqësore publike u zhvilluan në datat 27.01.2025, 19.02.2025, 05.03.2025 dhe 13.03.2025.

⁶ Aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

14. Trupi gjykues, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, si dhe nevojës për hetimin e çështjes, të evidentuar në ankimin e Komisionerit Publik, bazuar në nenin F, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe të kërkojë informacion nga shoqëria “{***}” ShPK në cilësinë e shoqërisë sipërmarrëse⁷, për sa i përket veprimeve të kryera nga kjo shoqëri lidhur me pasurinë “apartament me sipërfaqe 87,3 m² dhe verandë 73,5 m²”, Tiranë deklaruar në pronësi nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe të qartësonte mënyrën e pagesës për blerjen e kësaj pasurie, kohën e kryerjes së pagesave, shumat përkatëse dhe personat që i kanë realizuar ato. Gjithashtu, në kuadër të nevojës për hetimin e plotë të çështjes, referuar shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues vendosi të kërkojë nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (më parë me emërtesën “DSIK”) përditësimin e raportit nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk ishin marrë në shqyrtim gjatë hartimit të këtij raporti.

Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, trupi gjykues administroi përgjigjen e shoqërisë “{***}” ShPK⁸, sipas të cilës informacioni i kërkuar nga Kolegji lidhur me pasurinë “apartament me sipërfaqe 87,3 m² dhe verandë 73,5 m²”, Tiranë, nuk disponohej nga kjo shoqëri, për shkak të tejkalimit të afatit 5-vjeçar të parashikuar nga legjislacioni për ruajtjen e dokumentacionit dhe mbajtjen e kontabilitetit për qëllime tatimore.

*-Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 17.01.2025 i aktit Kontratë porosie nr. {***} prot., datë 02.04.2011, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe z. B. R., në cilësinë e palës porositëse.*

*-Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 17.01.2025 i aktit Kontratë porosie nr. {***} prot., datë 29.10.2010, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe z. B. L., në cilësinë e palës porositëse.*

*-Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, nr. {***} prot., datë 13.01.2025, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur së cilës gjendet kopja e fashikullit penal të procedimit penal nr. {***} të vitit 2022, njehsuar me vulë të njomë.*

*-Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, nr. {***} prot., datë 15.01.2025, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit, për përcjelljen e informacionit lidhur me statusin e gjykimin të procedimit penal nr. {***} të vitit 2022.*

-Aktet e administruara në çështjen e rivlerësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat i janë vënë ë dispozicion nga Kolegji.

⁷ *Me shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2025, Kolegji i kërkoj shoqërisë “{***}” ShPK t'i vinte në dispozicion informacionin mbi veprimet e kryera nga kjo shoqëri lidhur me pasurinë e deklaruar në pronësi nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur z. S. B., konkretisht pasurinë “apartament me sipërfaqe 87,3 m² dhe verandë 73,5 m²”, me adresë rruga “{***}”, pranë kompleksit “{***}”, Tiranë.*

⁸ *Shkresë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 11.02.2025, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.02.2025.*

Trupi gjykues administroi, gjithashtu, raportin e AKSIK-ut mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, të përditësuar, por si dokument i klasifikuar.

15. Në kuadër të denoncimit nga publiku të depozituar në Kolegj nga denoncuesi B. I.⁹, vënë në dispozicion paraprakisht palëve në këtë gjykim, në seancën gjyqësore të datës 19.02.2025, nga subjekti i rivlerësimit u paraqitën parashtrime, si dhe akte shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës, duke pretenduar se rrethanat e parashtruara nga denoncuesi janë të pabazuara. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në të njëjtën seancë gjyqësore, parashtrroi se denoncimi i mësipërm nuk përmbante rrethana të tilla, që do të ndikonin në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi denoncimin dhe rrethanat e parashtruara në të, si dhe pasi dëgjoi parashtrimet e palëve në gjykim lidhur me të, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos çelë hetimin gjyqësor, pasi denoncimi i depozituar nuk plotësonte kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.
 16. Në seancën gjyqësore publike të datës 05.03.2025, në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim edhe të provave të administruara në kuadër të këtij gjykimi, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr. 524, datë 08.04.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe subjekti i rivlerësimit.
 17. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues, vlerësoi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe parashtrimet e kërkimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar e vlerësuar të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.
- B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*
18. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit, *për pasurinë “apartament me sip. 87,3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m²”, përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është plotësisht i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me pagesën e kryer nga personi i lidhur pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 21.493,55 euro, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.*
 19. Trupi gjykues vëren se pretendimet e parashtruara nga Komisioneri Publik lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, kundërshtojnë konkluzionin e Komisionit lidhur me përfundimin e arritur se shuma 21.493,55 euro nuk përbën një shumë të paguar mbi vlerën e blerjes së pasurisë “apartament me sip. 87,3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m²”, Tiranë (në vijim “pasuria “apartament””), për të cilën nga hetimi administrativ i kryer në Komision, rezultoi sa vijon.

⁹ Denoncim i regjistruar në Kolegj, me nr. {***} prot., datë 16.08.2024.

19.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Pasuria me nr. {***}, nr. {***} ZK. Lloji i pasurisë “apartament” me sipërfaqe 87,3 m² dhe 73,5 m² verandë. Adresa: “{***}”, ish-Kompleksi Partizani, Tiranë. Vlera 104.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Kontrata e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.07.2012¹⁰.*

19.2. Origjina e pasurisë “apartament me sipërfaqe 87,3 m² dhe 73,5 m² verandë”, në rrugën “{***}”, Tiranë” (në vijim pasuria “apartament”), regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.07.2012 dhe kontrata e shitblerjes e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.07.2012, të lidhura mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S. B., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Pasuria është regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, më datë 13.08.2012, në pronësi të personit të lidhur¹¹.

19.3. Referuar pikës 2 të nenit 13 të kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar, me anë të së cilës bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S. B., ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, pasurinë “apartament”, çmimi i shitjes në vlerën 104.000 euro do të paguhej në këtë mënyrë: (i) 97.000 euro do të paguheshin me lidhjen e kontratës; dhe (ii) 7.000 euro do të paguheshin me dorëzimin e hipotekës. Porositësi duhet të kryente pagesën në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi, në rast të kundërt merrte përsipër shpenzimet për transfertën e kryer. E njëjta mënyrë pagesë konfirmohet edhe në shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, nr. {***} prot., datë 04.07.2012, e nënshkruar nga përfaqësuesi i saj, shoqëruar nënshkrimi me vulën e shoqërisë, si dhe nga z. S. B..

19.4. Në datën e lidhjes së kontratës së sipërcituar të sipërmarrjes, personi i lidhur ka paguar në arkën e shoqërisë shumën 97.000 euro, sipas mandatar-këtimit nr. {***}, datë 04.07.2012, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me përshkrim: “Pagesë për ap. {***}”, nënshkruar nga financieri i shoqërisë, shoqëruar nënshkrimi me vulën e shoqërisë, si dhe nga z. S. B..

Ndërsa kësti i dytë për blerjen e pasurisë “apartament”, është paguar nga personi i lidhur më datë 29.07.2012, referuar përmbajtjes së shkresës së thjeshtë, e mbajtur me shkrim dore, me emërtimin “Arkëtim”, datë 29.07.2012, sipas së cilës: “Z. S. B., apartamenti {***}, depozitoi sot në datën 29.07.2012, shumën 7.000 euro, për këstin e fundit të ZVRPP. Nesër, datë 30.07.2012, jemi gati për kontratën e shitjes”, nënshkruar nga znj. J. N..

¹⁰ Si burim krijimi të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “(i) depozita bankare në Raiffeisen Bank, në emër të S. B., datë 04.7.2012, në vlerën 3.000.000 lekë, ku janë depozituar të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit; (ii) huaja e marrë nga shtetasi P. G., me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 50.000 euro; (iii) huaja e marrë nga shtetasi I. H., me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 3.000.000 lekë; (iv) huaja e marrë nga shtetasi S. A., me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 1.200.000 lekë”.

Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit ka bërë edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2012.

¹¹ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2020, ka informuar Komisionin se në emër të z. S. B., figuron e regjistruar vetëm një pasuri, pasuria “apartament” objekt kontrolli, e cila, sipas kartelës së pasurisë, figuron e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, më datë 13.08.2012.

19.5. Në vijim, mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S. B. është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.07.2012, me objekt shitjen e një apartamenti. i identifikuar me nr. pasurie {***}, ZK {***}, me sipërfaqe banimi 87,3 m² dhe 73,5 m² verandë. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, çmimi i shitjes së pasurisë është 104.000 euro, për të cilin palët deklarojnë se është paguar totalisht nga blerësi, përpara lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka pretendime për të.

19.6. Shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2021, ka informuar Komisionin se *pagesa për këtë apartament është kryer nga z. S. B. me këste, në llogarinë bankare të shoqërisë dhe asnjë këst nuk është paguar cash në arkën e shoqërisë.*

Bashkëlidhur kësaj shkrese, shoqëria “{***}” ShPK ka depozituar në Komision:

(i) kontratën e sipërmarrjes dhe kontratën e shitblerjes së pasurisë apartament, të lidhura në vitin 2012, të cilat rezultojnë të njëjta me ato të depozituara nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit;

(ii) vërtetimin mbi lëvizjet e llogarisë bankare të shoqërisë në Bankën Credins, në të cilën evidentohen depozitimet *cash* të kryera nga z. S. B., në periudhën 30.07.2012 - 12.12.2012, si dhe vërtetimin mbi lëvizjet e llogarisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, sipas të cilit nga z. S. B., më datë 03.12.2012, është depozituar në *cash* shuma 21.493 euro, me përshkrimin: “Derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. {***}”;

(iii) kartelën kontabël të klientit S. B., e cila pasqyron kontratën e shitblerjes së apartamentit të datës 27.07.2012 dhe këstet e paguara në nëntë pagesa të kryera në Credins Bank dhe një pagesë e kryer në Bankën Kombëtare Tregtare, gjatë periudhës 30.07.2012 - 12.12.2012, në shumën totale 104.000 euro¹². Kartela mban nënshkrimin e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK dhe vulën me shënimin “{***}”;

(iv) deklaratën nr. {***} prot., datë 05.07.2012, “Për marrjen në dorëzim të njësisë nr. {***}”, në të cilën deklaruesi S. B. deklaron se, *duke qenë se kam kryer pagesën prej 97.000 eurosh dhe shumën prej 7.000 eurosh do ta paguaj kur të pajisem me dokumentin nga ZVRPP dhe nuk kam komente për punën e kryer me cilësi nga “{***}” ShPK, marr në dorëzim njësinë {***}*. Deklarata

¹² Sipas kartelës së klientit S. B., pagesat e kryera prej tij janë: në datë 30.07.2012 paguar shuma 7.000 euro në Bankën Credins; në datë 31.10.2012 paguar shuma 4.450 euro në Bankën Credins; në datë 06.11.2012 paguar shuma 5.500 euro në Bankën Credins; në datë 07.11.2012 paguar shuma 10.000 euro në Bankën Credins; në datë 15.11.2012 paguar shuma 4.000 euro në Bankën Credins; në datë 19.11.2012 paguar shuma 10.000 euro në Bankën Credins; në datë 26.11.2012 paguar shuma 10.000 euro në Bankën Credins; në datë 03.12.2012 paguar shuma 21.493 euro në Bankën Kombëtare Tregtare; në datë 11.12.2012 paguar shuma 27.000 euro në Bankën Credins; në datë 12.12.2012 paguar shuma 4.616 euro në Bankën Credins.

është nënshkruar nga z. S. B. dhe katër përfaqësues të shoqërisë dhe mban vulën e shoqërisë “{***}” ShPK.

19.7. Edhe në shkresën nr. {***} prot., datë 08.07.2021, shoqëria “{***}” ShPK ka informuar Komisionin se, nga verifikimi i dokumentacionit përkatës të së njëjtës praktikë shitjeje, rezulton se për blerjen e apartamentit nr. {***}, pagesat janë kryer nga vetë z. S. B., në llogarinë bankare të shoqërisë.

19.8. Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.06.2021, ka përcjellë në Komision *statement* të llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, gjatë periudhës 01.01.2012 - 31.12.2013, sipas të cilit rezulton se më datë 03.12.2012, në këtë llogari, është depozituar *cash* shuma 21.493,55 euro, nga z. S. B., me përshkrimin: “Derdhje për likuidim kësti, blerje apartamenti nr. {***}”.

19.9. Në përgjigje të pyetësorit, datë 20.9.2021, të drejtuar nga Komisioni, lidhur me pagesat e kryera nga bashkëshorti i saj për blerjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka deklaruar: *Të vetmet pagesa që janë bërë nga bashkëshorti, janë ato të kryera “cash” në dy këste. Një pagesë është bërë më datë 04.07.2012 (mandatarkëtimi nr. {***}, datë 04.07.2012, me vlerë 97.000 euro [...] pagesa tjetër apo kësti i fundit [...] është kryer më datë 29.07.2012. Për sa i përket konstatimit tuaj se në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në BKT, në monedhën euro, është evidentuar veprimi me referencë {***}, datë 03.12.2012, i cili në përshkrim të tij ka të cilësuar: “S. B., derdhje për likuidim kësti, blerje apartamenti nr. {***} (vlera totale 21.500 euro, komisioni 0,03 %, në vlerën 21.493,55 euro”, ju sqaroj se është kërkuar në BKT praktika lidhur me veprimin [...]. Pasi u njoha me këto dokumente, si unë dhe bashkëshorti im, konstatoam se shkrimi emër mbiemër S. B., si dhe nënshkrimi, nuk ishin shkrimi dhe nënshkrimi i bashkëshortit tim. Të ndodhur në këto kushte, duke qenë se dokumentet ishin të falsifikuara, bashkëshorti i ka kërkuar një ekspert privat që të kryejë një akt ekspertimi grafik [...]. Nga akti i ekspertimit grafik, datë 30.09.2021, ka rezultuar se: Dy nënshkrimet e plota – emër, mbiemër, firmë – të shkruara në emër të S. B., në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi S. B.. Dy nënshkrimet e plota emër mbiemër firmë, të shkruara në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person. Firmat në këto dy nënshkrime janë të sajura grafikisht. Dy nënshkrimet objekt ekspertimi përmbajnë gjurmë me vlera që identifikojnë autorin e tyre.*

19.10. Për sa u përket pagesave që kanë rezultuar të kryera në llogarinë e shoqërisë pranë Bankës Credins, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision shkresën e kësaj banke me nr. {***} prot., datë 01.10.2021, me anë të së cilës institucioni bankar ka konfirmuar derdhjet që janë kryer në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “S. B., likuidim këst apartamenti {***}”, duke i vënë në dispozicion mandatet bankare përkatëse, nga të cilat rezulton se nëntë transaksionet bankare nuk janë kryer nga personi i lidhur, pasi mandatet bankare janë nënshkruar nga znj. O. M. ose znj. S. A..

19.11. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision, gjithashtu, edhe shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, datë 01.10.2021, me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe z. S. B., në të cilën shoqëria i informon, se vlera e arkëtuar në shumën 97.000 euro, me mandat arkëtimi nr. {***}, datë 04.07.2012, është depozituar në bankë pjesë-pjesë, nga një përfaqësues i shoqërisë, sipas datave të konfirmuara nga *vërtetimet e lëvizjeve bankare* të lëshuara nga Banka Credins dhe Banka Kombëtare Tregtarë. Bashkëlidhur kësaj shkrese, shoqëria ka paraqitur edhe ekstrakt të kartelës së klientit, në të cilën evidentohen pagesat e kryera në llogarinë bankare në Bankën Credins dhe Bankën Kombëtare Tregtare, si depozitime në bankë nga punonjësi [ekonomisti] i shoqërisë.

19.12. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ¹³, subjekti i rivlerësimit, në vijim të shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, ka shpjeguar se:

[...] Sqaroj se në vitin 2012, bashkëshorti im ushtronte detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Ai udhëtonte çdo ditë, duke u nisur nga Tirana përpara orës 6:00 AM dhe kthehej në Tiranë pas orës 6:00 PM. Depozitimi i shumës në bankë, sipas praktikës së bankës, rezulton të jetë kryer në orën 09:44, ndërkohë që bashkëshorti në orën 09:00 - 09:10 ka qenë në një gjyq në Gjykatën e Rrethit Shkodër, më pas në orën 10:30 ka qenë në një gjyq tjetër dhe në orën 13:00 deri në 13:25 ka qenë në një gjyq tjetër, përsëri në Gjykatën e Rrethit Shkodër. Në këto kushte, bashkëshorti e ka pasur të pamundur të ishte njëkohësisht edhe në Shkodër, duke kryer me intensitet punën e tij (atë ditë ka qenë i pranishëm në tri seanca gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Shkodër, seanca të zhvilluara në orën 09:00, në orën 10:30 dhe në orën 13:00, si dhe ka marrë 3 vendime përfundimtare, përveç detyrave të tjera), edhe në Tiranë, që të kryente veprime në BKT. Pra, kjo provë e re, në unitet edhe me të gjitha provat e tjera të administruara gjatë hetimit, provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm se bashkëshorti nuk e ka kryer këtë depozitim. Gjithashtu, bëj me dije Komisionin se kam paraqitur edhe një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, ku kam kërkuar sekuestrimin e dokumenteve origjinale që kanë të bëjnë me veprimin bankar të datës 03.12.2012 dhe kryerjen e ekspertimit grafik të dokumenteve origjinale.

19.12.1. Për të provuar pretendimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision:

(i) Shkresë nr. {***} prot., datë 23.03.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga z. S. B., e informon këtë të fundit se, nga verifikimi i

¹³ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e pasurisë “apartament”, si vijojnë: “Duket se shuma prej 21.493,55 eurosh, depozituar më datë 03.12.2012 në BKT, është paguar personalisht nga bashkëshorti i subjektit. Subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e pagesës në shumën 21.493,55 euro, pasi, nga analiza financiare, për periudhën gusht-dhjetor 2012, ka rezultuar një bilanc negativ në shumën 964.440 lekë. Shuma prej 104.000 eurosh është paguar “cash” nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në arkën e shoqërisë “{***}” ShPK”.

planifikimit të seancave gjyqësore (orari i gjyqeve) për datën 03.12.2012, rezulton se z. B., në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka marrë pjesë në seancat gjyqësore në çështjet si më poshtë:

- çështja me nr. {***}, e zhvilluar më datë 03.12.2012, ora 09:00 - 09:10, me të pandehur shtetasin P. P.;

- çështja me nr. {***}, e zhvilluar më datë 03.12.2012, ora 10:30, (nuk rezulton e përshkruar në procesverbal ora e përfundimit të seancës), me të pandehur “{***}” ShPK, A. U. dhe T. Gj.;

- çështja me nr. {***}, e zhvilluar më datë 03.12.2012, ora 13:00 - 13:25, me të pandehur {***} etj.

(i.i) Bashkëlidhur kësaj shkrese, gjykata ka paraqitur:

- planifikimi i seancave gjyqësore të datës 03.12.2012, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, printuar nga sistemi elektronik, në të cilin figurojnë planifikimet e seancave gjyqësore të cituara më sipër;

- kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 03.12.2012, për çështjen me nr. {***}, me të pandehur {***} etj.;

- kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 03.12.2012, për çështjen me nr. {***}, me të pandehur shtetasin P. P.;

- kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 03.12.2012, për çështjen me nr. {***}, me të pandehur “{***}” ShPK, A. U. dhe T. Gj..

(ii) Shkresë nr. {***} prot., datë 23.03.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, e cila, në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga z. S. B., e informon këtë të fundit se nga verifikimi në regjistrin elektronik të njoftimit të veprave penale, rezulton se ai ka marrë në këtë datë, vendimet si vijojnë:

- procedimi penal nr. {***}, viti 2011, për veprën penale të parashikuar nga nenet 135 dhe 25 të Kodit Penal, kërkesë për gjykimin e çështjes penale;

- procedimi penal nr. {***}, viti 2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, vendim për pushimin e çështjes penale;

- procedimi penal nr. {***}, viti 2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, vendim për shpalljen e moskompetencës territoriale, si dhe vendim për kalimin e akteve të këtij procedimi.

(ii.i) Bashkëlidhur kësaj shkrese, Prokuroria ka paraqitur aktet e hartuara nga prokurori S. B., siç janë referuar në shkresë.

(iii) Kallëzim penal, me kallëzuese Elfrida Bregova, të kallëzuar Banka Kombëtare Tregtare, përpara Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt: “Kërkoj ndjekjen

penale për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Sipas dëftesës postare, kallëzimi është dorëzuar në Zyrën Postare më datë 25.03.2022. Në kallëzim, subjekti ka referuar, ndër të tjera: *Për sa më sipër, unë po ju drejtohem juve si organ kompetent për të sqaruar këtë fakt, pasi bashkëshorti im S. B. nuk ka kryer derdhje në bankë më datë 03.12.2012 dhe nuk ka shkruar dhe nënshkruar në mandatet përkatëse në cilësinë e personit që ka kryer derdhjen. Kërkoj nga ana juaj të kryhen veprimet hetimore përkatëse në lidhje me faktin e falsifikimit të këtyre dokumenteve, të vendoset sekuestrimi i dy dokumenteve origjinale që ndodhen në bankë, me qëllim kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit, si dhe të kryhen të gjitha veprimet hetimore për identifikimin e personit që ka kryer falsifikimin, si dhe të punonjësit/es të bankës që ka shpërdoruar detyrën.*

20. Komisioni, në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli, në përfundim të hetimit administrativ, ka arritur në konkluzionin se kjo pasuri është e ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, në verifikim dhe kontroll të pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për blerjen e pasurisë, në vendim¹⁴, ka arsyetuar se: “Komisioni, pasi vlerësoi këto fakte dhe prova, çmon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar *cash* vlerën e apartamentit në shumën 104.000 euro, e cila më pas është arkëtuar pjesë-pjesë nga shoqëria “{***}” ShPK në llogaritë e saj bankare në Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën Credins, për rrjedhojë, shuma 21.493,55 euro nuk përbën një shumë të paguar mbi vlerën e apartamentit. Në përfundim të kësaj analize, Komisioni vendosi që në analizën financiare të vitit 2012, të mos përfshijë shumën 21.493,55 euro, përtej vlerës prej 104.000 eurosh të paguar për apartamentin”.

21. Komisioneri Publik, në ankim, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, ka argumentuar se në vlerësimin e rrethanave të rastit, Komisioni u ka dhënë vëmendje provave me burim nga shoqëria “{***}” ShPK, ndërkohë që nga tërësia e akteve të administruara nga kjo shoqëri, gjatë hetimit administrativ, rezultojnë përgjigje kontradiktore lidhur me mënyrën e pagesës së çmimit, periodicitetin e pagesave dhe subjektet që i kanë realizuar ato. Komisioneri Publik vëren se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se çmimi i blerjes së pasurisë “apartament” është likuiduar *cash* në korrik të vitit 2012, mbetet i paqartë shkaku dhe qëllimi i depozitimit dhe i pranimit nga ana e shoqërisë ndërtuese, i pagesës së shumës 21.493,55 euro, në Bankën Kombëtare Tregtare, kryer në dhjetor 2012, pagesë kjo e identifikuar nga akti bankar si pagesë e kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me qëllim blerjen e kësaj pasurie. Në të tilla rrethana juridike kontradiktore, të paraqitura nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK, në lidhje me elemente të rëndësishme të kësaj marrëdhënieje kontraktuale të lidhur mes shoqërisë, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, e që kanë të bëjnë me momentin e pagesës së çmimit, si dhe subjektit që kryen pagesat, elemente që ndryshe deklarohen në korrespondencën e shoqërisë me Komisionin dhe ndryshe në aktet e hartuara për llogari të subjektit, Komisioneri Publik ka vlerësuar se është i

¹⁴ Paragrafi 25 i vendimit të Komisionit.

nevojshëm një hetim i mëtejshëm nga ana e Kolegjit, që do të lejonte administrimin në cilësinë e provës përpara gjykatës, nën përgjegjësinë ligjore përkatëse, të të gjitha veprimeve të kryera nga ana e shoqërisë në lidhje me pasurinë “apartament”, të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

22. Gjatë gjykimit në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime, konfirmoi qëndrimin e mbajtur nga Komisioneri Publik në ankim, si më sipër pasqyruar.
23. Në parashtrimet e paraqitura, si dhe në seancat gjyqësore publike të zhvilluara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për pasurinë “apartament”, në Tiranë, duke argumentuar se nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vlera e plotë e çmimit të pasurisë “apartament”, prej 104.000 eurosh, është likuiduar në *cash* nga ana e personit të lidhur, në dy këste dhe ai nuk ka kryer asnjë pagesë tjetër, pas datës së lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë. Veprimi bankar në Bankën Kombëtare Tregtare, datë 03.12.2012, i cili në përshkrimin e tij ka të cilësuar: “S. B., derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. {***}”, në vlerën 21.493,55 euro, nuk është kryer nga z. B.. Sipas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka evidentuar, përveç pagesës së sipërcituar, edhe nëntë pagesa të tjera të kryera në llogaritë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK në Bankën Credins, konkretisht: një pagesë në shumën 7.000 euro, e kryer më datë 30.07.2012 nga znj. O. M., si dhe tetë pagesa në shumën totale prej 75.566 eurosh, të kryera në periudhën 31.10.2012 deri më 12.12.2012, nga znj. S. A., punonjëse të shoqërisë. Kur personi i lidhur është njohur me këto dokumente, ka konstatuar se shkrimi – emër, mbiemër – si dhe nënshkrimi në dokumentet bankare që i përkasin veprimit bankar të kryer në Bankën Kombëtare Tregtare, më datë 03.12.2012, nuk ishin shkruar dhe nënshkruar prej tij. Duke qenë se dokumentet ishin të falsifikuara, z. B. i ka kërkuar një ekspert të pavarur kriminalist që të kryejë një akt ekspertimi grafik, nga i cili ka rezultuar se dy nënshkrimet e plota – emër, mbiemër firmë – të shkruara në emër të z. S. B., nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi S. B.. Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova të cilat tregojnë se bashkëshorti, ditën dhe orën në të cilën është kryer transaksioni bankar, ka qenë duke ushtruar detyrën e tij si prokuror, në rrethin Shkodër.

Nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, arrihet në konkluzionin e pakundërshtueshëm se z. B. ka paguar në *cash* të gjithë vlerën 104.000 euro, të çmimit të apartamentit [në datat 04.07.2012 dhe 29.07.2012] dhe e gjithë kjo shumë më pas është depozituar nga përfaqësues të shoqërisë në bankë [9 depozitimet në Bankën Credins, përfshirë edhe depozitimim në Bankën Kombëtare Tregtare përbëjnë të gjithë vlerën e apartamentit të paguar paraprakisht *cash*].

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision prova dokumentare që tregojnë plotësisht, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se shuma prej 21.493,55 eurosh dhe çdo depozitim tjetër në bankë nuk janë kryer nga z. B. dhe informacioni i dërguar në Komision nga shoqëria “{***}” ShPK me shkresat e datave 16.06.2021 dhe 08.07.2021, është i pasaktë.

Këto shkresa të shoqërisë që janë bërë shkak për ankimin e Komisionerit Publik, nuk janë në harmoni me provat e tjera me fuqi të plotë provuese, të administruara gjatë hetimit administrativ, por edhe me dokumentet e tjera shkrese të prodhuara nga kjo shoqëri, ashtu si me të drejtë ka konstatuar dhe arsyetuar Komisioni në vendim.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit vlerëson se ankimi i Komisionerit Publik, në lidhje me pagesën 21.493,55 euro, datë 03.12.2012, është tërësisht i pabazuar dhe pasaktësitë në shkresat e shoqërisë “{***}” SHPK janë sqaruar në mënyrë shteruese gjatë hetimit administrativ.

Pavarësisht sa më sipër, në respekt të procesit të rivlerësimit dhe meqenëse Komisioneri Publik ka kërkuar hetim të mëtejshëm, subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit gjyqësor, paraqiti dhe argumentet e poshtëshënuara, e në vijim dhe provat e paraqitura në mbështetje të tyre.

Në kuadër të ecurisë së hetimeve të zhvilluara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal – procedimi i regjistruar mbi kallëzimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit – janë kryer disa veprime hetimore. Nga aktet e ekspertimit grafik, përmbledhurazi, ka rezultuar se dokumenti objekt ekspertimi: mandatarkëtimi i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 03.12.2012, nuk është nënshkruar nga z. B..

Gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëshortit, Komisioni ka kryer hetime të pavarura lidhur me pagesën në fjalë dhe në vendimin nr. {***}, datë 13.01.2023, ka arritur në konkluzionin se shuma prej 21.493,55 eurosh nuk është paguar nga z. B.. Ky vendim është ankimuar nga z. B., por faktet që lidhen me pagesën e sipërcituar, nuk janë bërë objekt ankimi dhe, për rrjedhojë, konkluzionet e arritura nga Komisioni në lidhje me këtë fakt, kanë marrë formë të prerë, duke përbërë tashmë “gjë të gjykuar”.

24. Në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, referuar parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj lidhur me pasurinë “apartament”, në Tiranë, vlerësoi se u provua se pagesa në shumën 21.493,55 euro nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur dhe si rezultat nuk duhet konsideruar si pagesë e kryer nga subjekti dhe/ose personi i lidhur përtej vlerës prej 104.000 eurosh që përfaqëson vlerën e paguar për blerjen e kësaj pasurie.
25. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke pretenduar se shkak i ankimit lidhur me pasurinë “apartament” në Tiranë, nuk është i bazuar në prova.
26. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, parashtrimet dhe konkluzionet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, duke i vlerësuar këto të fundit në raport me kërkesat e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, analizoi si më poshtë, duke marrë në konsideratë e vlerësuar në harmoni se:

(i) Referuar kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.07.2012 dhe Kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë

27.07.2012, kontrata të lidhura mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S. B., për blerjen e pasurisë “apartament” në Tiranë, çmimi i shitjes së pasurisë është 104.000 euro. Ky çmim i përcaktuar në këto kontrata vjen në përputhje dhe me deklaratimet në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën e interesave të vitit 2012, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka renditur burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, burime të cilat i ka pasur të disponueshme në datën 04.07.2012, në shumën 7.200.000 lekë ose 52.378 euro¹⁵ dhe 50.000 euro, burime këto të konsideruara të ligjshme, të vlerësuara si të tilla edhe nga Komisioni dhe të pakontestuara dhe nga Komisioneri Publik, edhe në drejtim të disponueshmërisë së tyre.

(ii) Në deklaratën nr. {***} prot., datë 05.07.2012 “Për marrjen në dorëzim të njësisë nr. {***}”, personi i lidhur ka deklaruar se ka kryer pagesën prej 97.000 eurosh dhe shumën prej 7.000 eurosh do ta paguajë kur të pajiset me dokumentin nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, deklaratë e cila është nënshkruar nga z. S. B. dhe katër përfaqësues të shoqërisë dhe mban vulën e shoqërisë “{***}” ShPK.

(iii) Kartela kontabël e pagesave të kryera nga z. S. B., e paraqitur nga shoqëria “{***}” ShPK në Komision, pasqyronte dhjetë pagesa të pretenduara të kryera me depozitime në llogarinë bankare të shoqërisë nga z. B., mes të cilave edhe pagesa sipas transaksionit të datës 03.12.2012, në Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 21.493 euro. Të gjitha këto pagesa figurojnë të jenë kryer pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes, datë 27.07.2012. Një pasqyrim i tillë bie në kundërshtim me parashikimin e kontratës së shitjes, në të cilën të dyja palët me vullnet të lirë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së pasurisë prej 104.000 eurosh, është paguar totalisht nga blerësi, përpara lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka pretendime për të. Kontrata e shitjes është një akt i dyanshëm i nënshkruar nga palët, me vullnet të lirë përpara noterit publik. Sipas nenit 690 të Kodit Civil, kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Në ndryshim nga kontrata e shitjes e cila është një akt i dyanshëm, kartela kontabël është një akt i njëanshëm, i cili mban vetëm nënshkrimin e administratorit të shoqërisë.

(iv) Nga informacioni i përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, rezultoi se pasuria apartament në Tiranë është regjistruar në emër të z. S. B., më datë 13.08.2012, kur, referuar kartelës kontabël së klientit S. B., ky i fundit kishte paguar vetëm 7.000 euro, nga çmimi prej 104.000 eurosh. Por edhe nëse referenca mbetet vetëm tek pagesa e kryer në datë 03.12.2012, në shumën 21.493 euro, e cila sipas përshkrimit është kryer për blerjen e apartamentit nr. {***}, duket e palogjikshme qoftë nga pikëpamja juridike, por edhe ekonomike, që shitësi të lejonte që blerësi të paguante rreth 1/5 e çmimit të shitjes së pasurisë, 4 muaj pasi pasuria e paluajtshme ishte regjistruar në emër të blerësit.

(v) Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që personi i lidhur z. B. të ketë negociuar apo krijuar ndonjë marrëdhënie me shoqërinë “{***}” ShPK për blerjen e ndonjë pasurie tjetër nga kjo shoqëri, e cila të justifikonte kryerjen e pagesës në shumën 21.493 euro në datë 03.12.2012, edhe pse ky transaksion bankar e ka të përshkruar destinacionin e pagesës për blerjen e apartamentit. Nga informacioni i përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në Komision, rezultoi se pasuria “apartament” në Tiranë, vazhdon ende të jetë e vetmja pasuri e paluajtshme e subjektit të rivlerësimit dhe z. S. B..

¹⁵ Sipas kursit mesatar të këmbimit të monedhës lek në euro, për muajin korrik 2012, në vlerën 1 euro=137.46 lekë, të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

(vi) Nga informacionet e përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar e provuar se, në datë 03.12.2012 - datë e kryerjes së transaksionit bankar të rezultuar se është kryer prej tij, depozitim *cash* në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në orën e kryerjes së depozitimit në *cash*, z. B. ka qenë i angazhuar në detyrën e tij si prokuror, duke përfaqësuar akuzën në disa çështje gjyqësore në gjykatën e sipërcituar, si dhe ka përpiluar akte procedurale, duke e bërë kështu objektivist të pamundur prezencën e tij njëkohësisht edhe në arkën e Bankës Kombëtare Tregtare në Tiranë, për të kryer depozitimin në *cash* në shumën 21.493 euro.

(vii) Referuar akteve të procedimit penal nr. {***/2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar përkatësisht nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, procedim i regjistruar mbi kallëzimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se nga akti nr. {***}, datë 24.06.2022 (ekspertimi grafik shkrimi dhe nënshkrimi) dhe nga akti nr. {***}, datë 19.10.2022 (ekspertimi grafik shkrimi dhe nënshkrimi) i hartuar nga eksperti kriminalist i Institutit të Policisë Shkencore, ka rezultuar se dy nënshkrimet e plota – emër, mbiemër, firmë – të shkruara në emër të z. S. B., në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, konkretisht: mandatarëkëtimi i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 03.12.2012, me vlerë 21.493,55 euro; si dhe “Depozitim *cash* nga jotitullarë”, i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 03.12.2012, me vlerë 21.493,55 euro, nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi S. B. dhe shtetasja Elfrida Bregova.

(viii) Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratat e përfaqësuesve të shoqërisë sipërmarrëse dhe shitëse të pasurisë “apartament” objekt kontrolli, shoqërisë “{***}” ShPK, të cilët kanë deklaruar si më poshtë.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.06.2022 të z. F. B. administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe në deklaratimet e dhëna përpara Komisionit¹⁶ nga znj. A. P., përfaqësuese e kësaj shoqërie, me rastin e kryerjes së procesit të rivlerësimit për z. S. B., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesit e shoqërisë kanë konfirmuar se pagesat për blerjen e pasurisë “apartament”, janë kryer në *cash* nga z. B., sipas mandat arkëtimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe se këto shuma janë depozituar në bankë, pjesë-pjesë, në ditë të ndryshme, nga përfaqësuesit e shoqërisë “{***}” ShPK, në llogaritë bankare të shoqërisë pranë Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Credins.

27. Në vijim, në kushtet kur nga analiza dhe arsyetimi i mësipërm u krijua bindja se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pagesa në shumën prej 21.493,55 eurosh nuk është kryer nga ajo apo nga personi i lidhur, trupi gjykues çmoi se kjo shumë nuk duhet konsideruar si pagesë e kryer përtej vlerës prej 104.000 eurosh të paguar për blerjen e pasurisë “apartament”, në Tiranë.
28. Në mbështetje të konkluzionit të arritur, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet edhe në kushtet e

¹⁶ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.06.2022 e deklaruesit F. B. dhe procesverbali i Komisionit, “Për marrjen e deklaratimeve të znj. A. P.”, datë 07.07.2022, janë akte të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara nga trupi gjykues në cilësinë e provës, në seancën gjyqësore të datës 21.01.2025.

parashikuara nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

C. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

29. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se, në referencë të nevojës së kryerjes së një hetimi të plotë dhe verifikimit të ekzistencës eventuale të të gjitha kushteve të parashikuara nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, mangësitë në hetimin e Komisionit edhe në drejtim të administrimit të plotë të informacioneve nga të gjitha organet ndihmëse për kriterin e kontrollit të figurës, sikurse parashikon Kreu V i këtij ligji, për sa kohë rezulton të mos jetë administruar informacioni i ShISh-it, do të duhet të riparohen gjatë gjykimit të këtij ankimi në Kolegj, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.
30. Komisioni, në përfundim të vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës, në vendim¹⁷, ka arritur në konkluzionin: “Në përfundim të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.”
31. Në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 26.05.2021, të përcjellë në Komision, DSIK-ja ka informuar, ndër të tjera: “Për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Th. Bregova, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”. Në konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit. Në fund të raportit, DSIK-ja është shprehur: “Sqarojmë se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit”.
32. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, Komisioneri Publik ka paraqitur shkakun e ankimit të pasqyruar më sipër, në paragrafin 29, në këtë vendim.
33. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, në konfirmim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, pretendoi se në respektim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, për përbërjen dhe detyrat e grupit të punës në hartimin e raportit, në referencë të hetimit gjyqësor, është i nevojshëm përditësimi i raportit të datës 02.11.2017, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk janë marrë në shqyrtim gjatë hartimit të raportit të parë.
34. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimin e shkakut të ankimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, argumentoi se Raporti i Grupit të Punës për kontrollin e figurës rezultoi të jetë deklasifikuar plotësisht dhe bazuar edhe në këtë fakt, mos-shënimi i ekstremiteteve të shkresës së dërguar nga Shërbimi Informativ Shtetëror në DSIK, duhet të jetë një lapsus. Fakti që informacioni është deklasifikuar plotësisht tregon që shkresa është administruar. Mos-shënimi i ekstremiteteve të

¹⁷ Paragrafët 33.5 - 33.6. të vendimit të Komisionit.

shkresës nuk mund të prezumojë faktin që shkresa e Shërbimit Informativ Shtetëror nuk është administruar e për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky shkak ankimi është i pabazuar. Pavarësisht sa më sipër, subjekti i rivlerësimit u shpreh se nuk kishte kundërshtime për saktësimin e këtij momenti nga Kolegji.

35. Në kuadër të nevojës për hetimin e plotë të çështjes, referuar shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe parashtrimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues, në vijim të vendimit të ndërmjetëm të marrë në seancën gjyqësore të datës 27.01.2025, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2025, kërkoi nga AKSIK-u, përditësimin e raportit nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk ishin marrë në shqyrtim gjatë hartimit të këtij raporti.
36. AKSIK-u, në përgjigje të kërkesës, ka përcjellë pranë Kolegjit, informacionin dhe Raportin e përditësuar për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në formën e dokumentit të klasifikuar.

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në datën 18.02.2025, u paraqit pranë Kolegjit dhe u njoh me informacionin e përcjellë nga AKSIK-u.

Në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues për deklasifikimin e raportit të përditësuar për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit¹⁸, Shërbimi Informativ Shtetëror, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2025, ka përcjellë informacionin se drejtuesi i këtij institucioni, si Autoritet Klasifikues, me vendimin nr. {***} prot., datë 28.02.2025, ka vendosur përjashtimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.
37. Në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vijim të të dhënave të rezultuara nga hetimi i kryer në Kolegj, parashtrroi se raporti i DSIK-së “Mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova”, nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i cili ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, mbetet akti i referuar, për sa përmban si konstatim.
38. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, parashtrroi se, për sa kohë nga AKSIK-u është përcjellë raporti i përditësuar për kontrollin e figurës së kryer ndaj saj dhe Kolegji nuk ka vijuar me hetimin gjyqësor të mëtejshëm, deduktohet se nuk disponohen informacione në kuadër të të cilave Kolegji duhej t’i kishte ngarkuar barrë prove subjektit të rivlerësimit për të dhënë sqarime të mëtejshme apo të vinte në dispozicion prova me qëllim përmbysjen e barrës së provës. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit e konsideroi shkakun e ankimit të Komisionerit Publik të pabazuar, duke kërkuar mospranimin e tij.
39. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në raportin e përditësuar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të përcjellë nga AKSIK-u [ish-DSIK-ja] e të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, si dhe në mbështetje të kërkimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, vlerësoi se situata faktike mbeti e pandryshuar në drejtim të konstatimit për përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Efrida Bregova, sipas raportit me nr. {***} prot., datë 02.11.2017 të DSIK-së “Mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj Elfrida Bregova”, i deklasifikuar plotësisht.

¹⁸ Kërkesë e trupit gjykues e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2025.

40. Në konkluzion të sa trajtuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të kontrollit të figurës, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 dhe nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe gjendet e përshtatshme për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vendimi nr. 524, datë 08.04.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i bazuar në prova e në ligj dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 13.03.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi